ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL VITI**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **657-24-1546-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik në Komunën e Vitisë.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Eco Holding Group SH.P.K.**
NUI	**811915430**
Adresa	**Rr.Ferizajit, pn Gjilan**
Vendi	**Gjilan**
Kodi postar	**60000**
Numri Telefonit	**049380941**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Bashkim Haziri**
Adresa elektronike	**ecoholding.g@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**18.04.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik në Komunën e Vitisë.

Njoftimi per Kontrate me date: 04.03.2024;

LIoji i procedures dhe kontrates - Procedure e hapur, Punë;

Kriteri per dhenien e kontrates: tenderi i pergjegjshëm me çmim me te ulët;

Hapja e tendereve me date: 19.04.2024, ora: 13:00;

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kerkese per Informacione shtesë me date: 15.03.2024;

Pergjigjeja nga AK per Kerkesen per sqarim me date: 19.03.2024 (pasi gë ishte gabim teknik data e vendosur);

Kerkesa per rishqyrtim me date: 05.04.2024;

Vendim nga AK per kerkesen per rishqyrtim me date: 08.04.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 - Ligji per Prokurimit publik

Neni 7 - Ligji per Prokurimit publik

Neni 108/A, pika 2 - Ligji per Prokurimit publik

Neni 51.3 - Ligji per Prokurimit publik

Nenin 63 - Rregullorja per Prokurim Publik

Nenin 96, 97 - Rregullorja per Prokurim Publik

Neni 18.13 | RUOPP-se

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Lidhur me projektin: **Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik në Komunën e Vitisë**, parashtrojme ankese lidhur me procesin e ketije aktiviteti te prokurimit i cili po na cenon qdo te drejte per te ofertuar per shkak se dosja e tenderit permban kritere jashtezakonisht te cenueshme.

Me datën 19.03.2024, kemi marrë Përgjigjeje nga Autoritetit Kontraktues lidhur me Kerkesen tone per Rishqyrtim (sipas të cilit është konfirmuar se do të bëhet korigjimi DT pjesërisht, duke lenë apo mos u përgjigjur në mënyrë të detajuar për kërkesat tona tjera.

Më datë: 04.04.2024, AK ka bërë ndryshimin e DT por duke mos respektuar nenin 63 të Rregullorës për Prokurim Publik, si dhe duke bërë shkelje të nenit 96 dhe 97 të Rregullorës për prokurim publik nr.001/2022.

Duke u nisur nga dosja e tenderit dhe FDT, dhe pasi të bëhet Ndryshimi i DT dhe FDT-es, duhet shënuar në faqen e pare të DT (Dosja e Tenderit Versioni i Korigjuar dhe më datën të cilën është ngarkuar që rrjedhimishtë i bie 04.04.2024), e njejta nuk eshte bere.

Bazuar në nenin 63, paragrafi 63. 1.3, nënparagrafi (b). ku përcakton saktë Rregullat pas korigjimit të DT-ës, si:

*b.Kurdo që miratimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues do të bëjë publikimin e Njoftimit për korrigjim të gabimeve, duke përdorur formularin B54 dhe do të zgjas afatin e dorëzimit të tenderëve në përputhje me nenin 53 të LPP-se. Pra rrjedhimishtë AK është dashur konformë rregullave ta vazhdojë afatin nga data e korigjimit të DT-ës, edhe **10** ditë.*

Gjithashtu vlen edhe neni 108/A, pika 2, i LPP-se, lidhur me kerkesen per rishqyrtim e cila nuk eshte pezulluar pavaresisht kerkeses qe ne e kemi derguar, citojm:

2. Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar.

Bazuar në DT dhe FDT kemi vërejtur se ndryshime nuk janë bërë apo nuk janë eleminuar kërkesat diskriminuese dhe favorizuese, pasi kërkesat e paraqitura nuk përkojnë me aktivitetin e publikuar, vijojm:

Pretendimi nr. 1.

Sipas DT nenin 9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ku është kerkuar:

Kërkesa 2 (1) inxh.dipl.hidroteknik (ose master); me minimum, 3 vite pervojë; të jetë i certifikuar ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis. nje (1)inxh.dipl. i gjeodezisë (ose master) i licensuar nga AKK; NJë (1) bachelor të gjeodezisë të licensuar nga AKK. me minimum, 3 vite pervojë. Një bsc i ndertimtaris Konstruktiv, Nje bsc në inxhinieri ndërtimore dhe infrastrukture 3 vite përvojë. Një Master ose Msc.i. komunikacionit me se paku 3 vite përvojë pune në realizimin e projekteve të ngjashme;

Duke marrë për bazë natyrën e punëve të cilat do të ekzekutohen sipas paramasës së publikuar së bashku me DT dhe njoftimin për kontratë, kërkesat kualifikuese në pikën 2 janë të pa nevojshëm pasi që - në Paramasë nuk ka pozicion për kanalizim, inxh i

Hidroteknikës është i pa nevojshëm e sidomos kerkesa qe i njejti te jete i certifikuar si Ekspert per vleresimin e ndikimit ne mjedis, po ashtu keni kërkuar edhe 2 Ing të gjeodezisë si dhe kompani të licencuar për matje gjoedezike, kërkojmë që të bëhet aprovimi i kërkesës tonë dhe të mbetet vetem njera nga keto te tre kerkesat pasi nje gjeodet mund ti kryej te gjitha punet e parapara per kete projekt.

Pretendimi nr.2:

Kërkesa 3, OE ose Grupi te ofroj nje Liste e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik në dosje te tenderit tek Aneksi 7.

Mekanizmi i paraqitur për ketë projekt është diskriminues, përjashtues për OE të cilët kanë interes për pjesemarrje ofertuese. Në kuptimin e nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-ës ku ndër të tjera përcaktohet se si AK duhet vepruar: *1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në **mënyrë të barabartë** dhe **jo-diskriminuese** dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

*2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që **redukton apo eliminon konkurrencën** në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.*

Në listën e mekanizmit me numër rendor 2, 7, 9, 17, 24, 25,

Buldozer me lopat deri 3 T;

Eskavator deri 1 T;

Kamionet kipper deri 1 T;

Damper 3-4 T;

Kamion me kran me peshë bartse 12 T;

Mini damper deri 500 kg;

Auto mikser per prodhimin e betonit vete ngarkus me regjistrim;

Cilinder me dhembza min 13 T

Keto kritere perqojne vetem kritere diskriminuese ndaj te gjithe OE te cilet po ballafaqohen me dosjen e tille, fillimisht caktimi i Buldozerit te peshes se tille dhe me lopate deri 3T, ne besojme se eshte i panevojshem pasi kemi mjete te shumta qe mund te kryejn funksionin e njejte.

Caktimi i peshes me vetem 1 ton diference: Eskavatori deri 1T, Kamioni Kiper deri 1 T, Damperi 3-4T, e njejta vlen edhe per Mini damper deri 500kg, e cila perfshin vetem 500kg, keto kritere jane mjaft diskriminuese dhe padyshim jo shume te nevojshme sepse ne DT kerkohen 32 paisje per projektin qe perfshine ndertimin e trotuareve, dhe na lene te kuptojme se AK po favorizion OE, si dhe bien ndesh me qellimin e LPP-se si dhe ndesh me vet nenin 7, citojme:

Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1.Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2.Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

Andaj as ju si Organ shqytues i prokurimit, nuk duhet ti lejoni nje AK te beje diskriminime te cilat elemminojn konkurrencen, me kritere gati se edhe te pamundura te gjenden.

Caktimi i peshes fikse si ne rastin e Kamionit me kran me peshe bartese 12 ton, eshte i papranueshem sepse ligjerisht eshte e precizuar qe pesha/kapaciteti te mund te caktohet me **minimum ose maksimum** te peshes/kapacitetit, mirpo vendosja e nje kriteri te till specifik bije ne kundershtim te gjitha normat ligjore te aplikueshme (bazohemi perseri ne nenet e cekura me larte).

Auto mikser per prodhimin e betonit vete ngarkus me regjistrim, ne edhe ketu shfaqim dyshime per favorizime ndaj operatoreve ekonomik pasi qe sot teknologjia ka avansuar deri ne ate mase qe tani betoni vjen i gatshem pavaresishte pozicioneve ne teren, pasi

eshte mjaft e persosur

Cilindri me dhembza, padyshim i panevojshem per shkak se ne DT jane kerkuar edhe tre cilindra te tjere me pesha te ndryshme...

Ne keto pretendime i bazojm edhe ne:

Neni 18.13 | RUOPP-se, i cili thote:

Eshte e ndaluar pergatitia e dosjes se tenderit ne nje menyre qe favorizon ose diskriminon kunder nje ose me shume se nje Operator Ekonomik potencial.

Neni 51.3. Te githa kriteret e pčrzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kerkuara qe jane vendosur dhe perfshir ne kete nen, duhet te jene drejtperdrejte relevante dhe proporcionale ne raport me lenden e kontrates perkatese.

AK ka shkaktuar shkelje të dispozitave ligjore, duke tejkaluar kompetencat nga kornizat e rregullave për Prokurim Publik, andaj kërkojmë që të merren për bazë pretendimet ankimore dhe të njejtat të aprovohet si të tërsishme dhe të mirëqenjëta.

Andaj duke u bazuar ne argumentet dhe provat e paraqitura me larte, kerkome nga OSHP te ndermarre veprime korrigjuese ne pajtueshmeri me kerkesat ligjore, ne ate menyre qe te nxjerre kete:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar Ankesa e OE: Eco Holding Group SH.P.K.

OBLIGOHET, Autoriteti Kontraktues qe te beje korrigjimin e dosjes se tenderit dhe modifikimin e dosjes ne teresi

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Pamundesia e aplikimit, shuma 5,000 euro per dergimin e lendes ne OSHP

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*